



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.591/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Skenderaj, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 19.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

PRANOHET E BAZUAR ankesa Anr.591/2025, e datës 16.02.2025, e parashtruar nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Skenderaj, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, ashtu që **urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), respektivisht Qendra Komunale e Numërimit në Skenderaj që 145 fletëvotime në vendvotimin-kutia e votimit Nr.2110/01, të vlerësohen si të vlefshme dhe të njëjtat të rinumërohen dhe të përfshihen në rezultatin zgjedhor.

A r s y e t i m

Me datë 16.02.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se në Qendrën Komunale të Numërimit në Komunën e Skenderajt, me datën 15.02.2025, pas numërimit të kutisë së votimit sa i përket vendvotimit 2110/01, ku 154 fletëvotime rezultojnë të pavlefshme, pasi që këto fletëvotime kanë qenë të dëmtuara në pjesën e sipërme për çka të njëjtat i bënë të pavlefshme. Po ashtu në ankesë pretendojnë se fletëvotimet kanë qenë të vlefshme në qendrën e votimit gjatë procesit të numërimit dhe për këtë arsye ekziston dyshimi i arsyeshëm se këto fletëvotime janë dëmtuar pas pranimit të kutive në Qendrën Komunale të Numërimit në Komunën e Skenderajt dhe në asnjë mënyrë nuk mundë të tjetërsohet vullneti i

votuesit, dhe duke i shpallur të pavlefshme këto fletëvotime vetëm për faktin se të njëjtat janë dëmtuar gjatë hapjes së kutive në Qendrën Komunale të Numërimit. Më tutje në ankesë pretendojnë, se duke u bazuar në numrin e fletëvotimeve të vlefshme të cekura më lart si dhe vendvotimit, dhe duke u bazuar në informatat që kanë pranuar nga vëzhguesit përkatës në këtë QNR, konsiderojnë që të urdhërohet rinumërimi i vendvotimit 2110/01, që të evitohet dhe pamundësohet në këtë mënyrë çdo keqpërdorim apo tjetërsim i vullnetit qytetar si dhe kërkojnë hetimin shtesë në lidhje me këto fletëvotime, duke rishikuar kamerat e procesit të numërimit të votave në QKN në Komunën e Skenderajt, lidhur me vendvotimin 2110/01, ashtu që në këtë mënyrë do të sigurohet transparenca dhe integriteti i procesit zgjedhor.

Në ankesë theksojnë se një pretendim të tillë e argumenton edhe krahasimi dhe mospërputhja në mes të FPR e plotësuar në Qendrën e Votimit dhe FPR e plotësuar në QKN, në të cilat vërehet se fletëvotimet janë shpallur të pavlefshme vetëm në QKN, duke cekur arsyen se të njëjtat kanë qene të dëmtuara në pjesën e sipërme. Andaj kërkojnë nga PZAP-i, që të urdhëroj KQZ-në që të rinumëroj fletëvotimet në vendvotimin e cekur më lart, me qëllim të evitimit të çfarëdo tjetërsimi të vullnetit të qytetarëve.

Si prove ankesës ja ka bashkangjitur FPR nga Qendra e Numërimit , FPR nga Qendra Komunale e Numërimit në Skenderaj, Fletëvotimet përkatëse, Emrat dhe nënshkrimet e anëtarëve të komisionit.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja lidhur me shpalljen e fletëvotimeve të pavlefshme në ditën e zgjedhjeve në vendvotimin 2110/01, si dhe kërkesën për rinumërimin në vendvotim, në bazë të pretendimeve të palës ankuese KQZ thekson se duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 1.38 të Ligjit Nr.08/L-288 LZP-së ,Qendra Komunale e Numërimit(QKN), si dhe bazuar në nenin 5 paragrafi 1.4 te Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 Qendrat Komunale te Numërimit , nder Funkcionet e QKN është edhe numërimi i fletëvotimeve dhe votave te kandidateve te subjekteve politike. Andaj bazuar ne nenin 15 paragrafi 7.2.3 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024, Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, ku fletëvotimet e dëmtuara numërohen dhe vendosen prapë në zarfin e caktuar për fletëvotime të dëmtuara.

Pas pranimit të kërkesës së PZAP-it, KQZ menjëherë ka kontaktuar me KKZ e komunës së Skenderajt, duke pranuar përgjigjen dhe sqarimet si në vijim: KKZ, në komunën e Skenderajt, ka njoftuar KQZ, lidhur me ankesën e palës ankuese se, në Vendvotimin Nr. 2110/01 , KKZ së bashku me trajnerët i këshillojnë se fletëvotimet a janë në përputhje me amat të cilat janë brenda kutisë dhe vlerësimin e shkëputjes së fletëvotimit dhe përputhja me amat në kuti, fletëvotimet të cilat ishin shkëputur më poshtë se amat ishin të njëjta me ato të amave, dhe me qenë se nuk u pajtuan se si të vendosin a të vlefshme apo të pavlefshme e hedhen në votim, andaj Kryesuesi dhe dy anëtarët ishin që fletëvotimet në fjalë i barten si të pa vlefshme edhe pse kane qenë në thesin (4), (sipas doracakut të votimit dhe numërimit në vendvotim në thesin numër 4 vendosen fletëvotimet e vlefshme të numëruara), ndërsa një anëtar ka qenë kundër që këto vota të shpallen të pavlefshme. Ndërsa kutia Nr.2110/01 është proceduar si e rregullt”. Në përgjigje në ankesë KQZ, thekson se i gjithë materiali zgjedhor dhe kamerat e sigurisë për momentin gjenden në QKN të komunave në fjalë dhe se pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN dhe se i njëjti material zgjedhor nga QKN

dorëzohet në QNR, dhe se te njëjtat mundë të verifikohen dhe hetohen nga PZAP-i dhe organet e drejtësisë.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjet në ankesë ka gjetur se:

Ankesa është e bazuar.

Paneli vlerësoi se pretendimet e parashtruara në ankesë nga subjekti politik PDK me të cilën pretendon se për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Komunën e Skenderajt gjatë numërimit fletëvotimet janë dëmtuar në pjesën e sipërme për çka të njëjtat i bënë të pavlefshme dhe se fletëvotimet në fjalë janë dëmtuar pas pranimit të kutive në QKN, paneli i vlerësoi se janë të qëndrueshme, pasi që nga hetimi i kryer nga ana e Panelit janë vërtetuar të gjitha këto pretendime.

Nga hetimi i kryer nga ana e ekipit hetues të PZAP-it, me datën 19.02.2025 është konstatuar kjo gjendje faktike: në Kutinë 2110/01, kanë qenë 154 fletëvotime të vlerësuara si të pavlefshme nga numërimi i komisionerëve në QKN, ndërsa të njëjtat të numëruara në VV përkatës janë konstatuar si të vlefshme. Poashtu, Pzap-i gjatë hetimeve të kryera ka konstatuar se në mesin e këtyre 154 fletëvotimeve janë gjetur: 14 - fletëvotime të vlefshme, 7 – fletëvotime të dëmtuara/të pavlefshme, 131 – fletëvotime të dëmtuara pa numër serik, por të votuara në mënyrë të rregullt nga votuesit dhe 2 – fletëvotime të paplotësuara.

Andaj nga kjo gjendje faktike, Paneli ka vlerësuar se nga ana e Qendrës Komunale të Numërimit (QKN), prej 154 fletëvotimeve të shpallura të pavlefshme 131 fletëvotime gabimisht janë shpallur të pavlefshme, pasi që përkundër se të njëjtat kanë qenë të dëmtuara, ato janë bërë nga ana e zyrtarëve të KQZ-së, gjatë procedurës së numërimit dhe për të njëjtat nuk mbajnë përgjegjësi votuesit dhe për këto nuk mund të dëmtohen subjektet e caktuara, ndërsa 14 fletëvotime kanë qenë të vlefshme, por që gabimisht janë shpallur të pavlefshme, ndërsa 7 prej tyre kanë qenë të pavlefshme, pasi që nuk është ditur qëllimi i votuesit dhe 2 poashtu të pavlefshme pasi që kanë qenë të paplotësuara, andaj paneli vlerëson se 145 fletëvotime janë shpallur gabimisht të pavlefshme në kundërshtim me dispozitën ligjore nga neni 16 par.3 i rregullores Nr.12.2024, për të cilën e urdhëroi KQZ-në, përkatësisht QKN në Skenderaj që të njëjtat ti konsideroi si të vlefshme, ti rinumëroi dhe ti përfshijë në rezultat.

Bazuar në të lartcekurat, paneli duke u mbështetur në nenin 16 par.3 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024, konstaton se votat konsiderohen të pavlefshme vetëm në rastet si në vijim: Votohet më shumë se një subjekt politik, nuk votohet asnjë subjekt politik, votohet vetëm kandidati e jo subjekti politik, dhe qëllimi i votuesit nuk është i qartë sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim. Prandaj në rastin konkret 145 fletëvotimet të cilat janë shpallur të pavlefshme nuk hyjnë në kategorinë fletëvotimeve të pavlefshme siç e parashohin dispozitat ligjore e lartcekur, ndërsa për 9 fletëvotime kanë rezultuar si të pavlefshme pasie 7 prej tyre qëllimi i votuesit nuk ka qenë i qartë, ndërsa 2 prej tyre nuk është votuar asnjë subjekt politik e as ndonjë kandidat, andaj këto 9 fletëvotime me të drejtë janë shpallur të pavlefshme nga ana e QKN-së.

Nga të gjitha këto arsye e duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par. 4, lidhur me nenin 118 par. 1 të LZP-së, lidhur me nenin 13 par.10 nënpar.10.1 të Rregullores së PZAP-së (Nr.01/2024), u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.591/2025, datë 19.02.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.

